



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 8/15

Prishtinë, më 27.2.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Donika Kadaj-Bujupi, Enver Hoti, dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, dhe Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Ymer Havolli – Kryetar i Bordit të FKPK-së, Ruzhdi Morina – Antar i Bordit të FKPK-së dhe Adrian Zalli – Drejtor Ekzekutiv i FKPK-së

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger nga GIZ, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Florinana Shala nga OSBE dhe Shefki Kastrati nga NDI

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 18.2.2015;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015;**
- 4. Caktimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit;**
- 5. Caktimi i grupit punues për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 18.2.2015

Kryetari - konstatoj se komisioni miratoi procesverbalin pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015

Kryetari - njofton se Fondi i Kursimeve të Kosovës ka bërë një kërkesë për miratimin e taksës menaxhuese për vitin 2015, përkatësisht për miratimin e taksës investive dhe operacionale. Kërkesa është mbështetur në nenin 2.1 të Ligjit nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për fondet pensionale.

Ymer Havolli – informoj se performanca e trustit të kursimeve pensionale për vitin 2014 ka qenë relativisht e kënaqshme. Kthimi bruto ka qenë rreth 67 milion ose 6.3% te mjeteve te investuara. Në tri vitet e fundit janë akumuluar 192 milion euro. Në bazë të aplikimit të strategjisë së vitit kaluar është rrit numri i aset menaxhereve për gjashtë. Arsyeja e rritjes së aset menaxhereve ka të bëjë me diversifikimin e mjeteve dhe si rezultat mundësia e rënies ose kthimi negativ është më pak i reduktuar. Kjo strategji e tillë ka tregue sukses te Fondi. Si rast konkret nën menaxhim janë mbi 1.1 miliard euro, në ndryshim prej vitit kaluar që ka qenë 914,000,000 euro. Sa i përket investimeve në Kosove në mënyrë të vazhdueshme Trusti marr pjesë në tenderë. Deri tani investimet kanë qenë në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës, që kanë qenë e vetmja mundësi ligjore e investimit në tregun e brendshëm. Bordi i ka propozuar Kuvendit të aprovoj taksen operacionale prej 0.095, ndërsa taksa për investime të mbetet e njëjtë si vitin e kaluar.

Kryetari – sqaroi se neni 2, paragrafi 2 i ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, parasheh se në rast se Kuvendi nuk mund të miratojë taksën investive dhe operacionale për vitin vijues, taksa e vitit paraprak mbetet në fuqi deri në vendimin e ri të Kuvendit.

Safete Hadergjonaj – theksoi se ne kemi shikuar materialin e dërguar nga ana e Fondit. Fillimisht, do të ishte është më mirë të përmirësohet emri i institucionit në vend të fjalës “Trust”, të shënohet “Fond”, sepse kështu e parasheh ligji. Komisioni pasi që të shqyrtojë kërkesën tuaj, duhet të raportoj në Kuvend, prandaj do të ishte mirë që komisioni të ketë shënime më të metalizuara, në lidhje me shpenzimet operacionale dhe investive. Është mirë të ketë një sqarim se nga rrjedhë suficiti i taksave menaxhuese, konkretisht a është përfshi suficiti në taksen investive dhe operacionale? Komisionit i duhen sqarimet në disa kategori të buxhetit operacional. Në buxhet keni paraparë rritje të mjeteve për kompensim të bordit drejtues. E ka të vështirë komisioni të pranoj rritjen prej 49,000 euro pa shënime me të detalizuara. Kemi vërejt se është e përfshire shujta tek buxheti operacional? Shujta nuk ju ka miratue asnjë institucioni prandaj është e vështirë me arsyetue këtë ngritje të mjeteve për 15,000 euro. Ne po e shohim qe e keni planifikuar buxhetin për 28 punësuar dhe për këtë persona, mesatarja e pagës po del 1,327 euro. Prandaj, unë mendojë se komisioni ka nevojë për shënime më të metalizuara, në mënyrë që të kalkulohet më mirë taksa operacionale dhe investive. Në ligj është parapare që në rast se ju keni probleme me deficit ose mos mundësinë e pagesës së aset-menaxhereve gjatë vitit, mund të propozoni takës shtesë investime dhe Kuvendi vendos.

Besa Gaxherri - theksoi se në bazë të buxhetit të propozuar nga Trusti, pikërisht tek shpenzimet e personelit, paga mesatare për 28 pozita po del 1280 euro neto. Me qenë se është ngrit çështja e profesionalizmit, me duhet ta theksoj se çdo vit janë ndarë mjete për trajnime dhe mendojë që stafi është dashtë me arrit një profesionalizëm, dhe pikërisht në këtë kategori për trajnime, ju ende kërkonit të njëjtën shumë prej 15,000 euro. Përveç kësaj keni paraparë shpenzime edhe për konsulentë, që nënkupton se stafi ende nuk ka arrit një profesionalizëm të nivelit të lartë. Në kërkesë është dashur të

jenë të dhëna më të qarta për zhvlerësimin dhe amortizimin, dhe shuma 124,000 euro për shpenzimet e operimit të zyrës është e pajustificuar. Sa i përket marrëdhënies me publikun dhe korrespondenca, sinjerisht unë nuk kam pa asnjë reklamë në televizor për Trustin Pensional, përveç ndonjë dërgese me postë. Prandaj, nuk di se ku janë harxhuar 267,000 dhe i kërkon edhe 203,000 tjera. Keni parapa një kategori “të ndryshme”, dhe e kam parasysh që kur ke suficit, dikund duhet me i planifikue shpenzimet. Por po ju paralajmëroj se këtu asnjë shpenzim nuk ka me lejue në këtë mënyrë. Ne kemi kursye 12 milion euro prej buxhetit të qeverisë, ku janë ulur shpenzimet operative në çdo ministri e organizatë buxhetore. Me intereson të dijë, çka është planifikuar për sigurimin fiduciar?

Ruzhdi Morina - sqaroj se në rast se dikush na padisë për vendime të gabuar, atëherë është sigurimi fiduciar.

Kryetari – a vlen sigurimi fiduciar veç për ndërkombëtar?

Ruzhdi Morina – sqaroj se sigurimi fiduciar është për të gjithë bordin dhe ky sigurim është i parapamë me ligj.

Besa Gaxherri – taksa operative duhet të rishikohet dhe të analizohet. Propozojë që të hënën, në një takim të komisionit, të marrim një vendim.

Enver Hoti – taksa investive mund të jetë si është e rekomanduar nga Trusti. Sa i përket taksës operative, ajo është vërtet pak shqetësuese. Kompensimet +46.7% dhe reprezentacionet/daljet zyrtare +100%, janë të pajustificuara në rrethanat që është vendi. Shujtat nuk janë pranuar ende të zbatohen nga qeveria, prandaj është një luks që ky institucion e kërkon. Në përfundim taksa operacinale është e pajustificuar për mendimin tim si deputet dhe nuk do ta mbështes. Pajtohem të ketë një takim të hënën, në mënyrë që të elaborohet më shumë, dhe pastaj të vendosim.

Latif Gashi – thekoi se edhe gjatë mandatit që kaloj jemi mundue me kuptue punën e juaj, dhe të gjitha problematikat që i keni pasur. Ligjin e keni shfrytëzuar në maximum për beneficione të stafit. Edhe gjatë mandatit që shkoj kemi pas diskutime me i zvogëlue pagat dhe me e reduktue numrin e institucioneve të pavarura. Prandaj ju propozoj që të dërgoni material të arsyeshëm shtesë, për mos me marr na një vendim pa vullnetin e Trustit. Të shikoni të bëni reduktime ku ka mundësi, që ne deputetët të marrim një vendim me konsensus, pa pengesa të punën tuaj.

Bardhyl Meta – përkundër të gjithave që janë përmend këtu, dua ta përgëzoj ekipin e trustit, për arritjet në kthim pozitiv të vlerës së mjeteve prej 6.3%. Për dallim prej kompanive tjera siç është Posta apo KEK-u, tek Trusti e kemi një shembull të mire të punës dhe shihet se ky institucion publik, ka arritur ta menaxhoj paranë publike në mënyrë profesionale. Sa i përket shpenzimeve operative, Trusti e parashih nevojën për kategorinë e relacioneve me publikun, që të jetë në atë shumë si është kërkuar. Nëse dikush kundërshton, atëherë prej ndërgjegjes më vjen me pyet, nëse shifra e kthimit kishte me qenë minus, cili këtu mund të kthej atë në plus. Unë kam problem me shujtën, tjetër problem me shpenzimet e planifikuara nuk kam. A duhet na me i respektue veç ndërkombëtarët? A nuk bënë ekspertit vendor me marr hakun e punës? Çdo investitor e quan sukses, kur ka kthim 5%, për mjete e investuar prej 100 milion euro. Është pozitive shpërndarja e riskut në më shumë aset-menaxher. Përndryshe nëse shkojmë me detaje, kërkohet provoja menaxheriale. Ose duhet me qenë profesional ose principiell dhe është mirë me i përfshi që të dyjat kur flasim.

Fikrim Damka – pajtohem me vërejtjet sa i përket pagave, si shembull del qe Kryeministri i Kosovës të krahasohet me një punëtor të thjesht të Trustit. Edhe në qeveri kemi ekspertët të një niveli të lartë që me

trajtime e kanë arritur atë titull. Nga buxheti për investime, është më interes të kemi informata të hollësishme, se në cilin vend gjinden mjetet dhe sa është investuar në secilin vend.

Safete Hadergjona – a është i përfshirë suficiti në kalkulimet e taksës manaxhuese?

Ymer Havolli – sa i përket suficitit është akumuluar dhe e kemi daklluar në atë formë siç është dhe është përfshirë në buxhetin e planifikuar. Sa i përket pagave, paga neto në trust është rreth 960 euro, ndërsa unë si kryesues i bordit marrë 1,250 euro. Kompensimi nuk ka ndryshuar që nga viti 2002 ju e dini sa ka qenë vlera atëherë dhe sa është tani. Tregjet financiare në Kosovë nuk funksionojnë dhe për me krijue një ekspert i cili vepron në “Wall Street”, i nevojitet bukur shumë kohë. Sa i përket marketingut, ju lajmëroj që 450,000 fletëpasqyra janë dërguar secilit në shtëpi. Ne e kemi paraqitur kërkesën Kuvendit, por nëse mendoni ndryshe, ska problem.

Ruzhdi Morina – sipas mendimit të bordit, ne kemi sjell një buxhet të mirë, dhe me këtë buxhet mund të tregojmë rezultate të ngjashme si deri me tani, mirëpo nëse ju mendoni ndryshe nuk ka asnjë problem.

Ymer Havolli – si trust e kemi apliku praktikën e raportimit të aset menaxhereve. Dhe kur e kemi njoftu “Vanguard”, që duhet me raportue para neve për mjetet, ata filluan të qeshin.

Besa Gaxherri – raportimi është i obligim i secilit, që paguhet për një punë të tillë.

Kryetari – anëtarët e bordit jeni të zgjedhur me krye punën dhe nuk jeni të zgjedhur që para deputetëve me bë krahasime me të tjerët. Ju i keni përgjegjësit e juaja sipas ligji dhe raportoni për punën tuaj. Nuk ka nevojë për emocione, unë thash që deputet janë politik nuk janë ekspert e as domosdoshmërisht profesional. Kështu që pyetjet mund të jenë gjithfarë dhe nuk keni nevojë me u bë nervoz.

Ruzhdi Morina – kjo kërkesë që e kemi sjell është një propozim profesional sipas bordit. Çfarë do vendimi që ju merrni na veç e zbatojmë. Sa i përket pagave është e vërtet që një pjesë e stafit menaxheria i kanë pagat më të larta, por iu nevojiten njohurit financiare që vazhdimisht kanë kontakt me tregjet financiare dhe me bursa financiare.

Besa Gaxherri – pyeti a keni arrit me pas titull eksperti?

Ruzhdi Morina – stafi menaxheria, janë ekspert menaxhues që nuk janë pjesë e bordit dhe një pjesë tjetër janë staf i IT-së. Kemi 450,000 llogari individuale të secilit prej neve, që menaxhohen prej një softveri të IT-së dhe ata duhet me qenë vërtet ekspert të lartë të kësaj fushe. Sa i përket shujtës, ne e kemi kuptuar që është nënshkruar kontrata kolektive ne nivel vendi dhe në aty është shkruar se të gjitha institucionet që kanë mundësi duhet me zbatue. Nuk ka problem se nuk është kosto e madhe shujta për 27 punëtor sa ka fondi, dhe mundemi me heq.

Kryetari – mandatin tuaj si bord e konsideroj te suksesshëm edhe pse në disa vite, ka pasur rënie të vlerës së mjeteve, por e keni përmbushur me sukses misionin. Ky fond është i varur në tregun ndërkombëtar e jo vendor. Kam nevojë që drejtori ekzekutiv me sqarue çështjen e suficitit. Ne e kemi një ligje që parasheh që nëse keni nevojë për mjete shtesë për investime mund të kërkohet taksë shtesë investive dhe ne si Kuvend vendosim. Nëse ky nen është i qartë pese ju kërkoni me pas suficitin.

Adrian Zalli – herën e fundit kur e keni aprovuar taksën manaxhuese, ka qenë një taksë për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investive. Ne nuk kemi angazhuar aset menaxher tjerë deri ne gjysmë vjetorin e dytë të vitit kaluar. Si rezultat kanë mbet mjetet në suficit për gjashtë muajt e parë. Suficiti

prej 850,000 euro, qe i kemi deklaruar ne faqen e dytë e kemi zbritur prej parashikimeve qe i bëjmë për vitin 2015, përndryshe e kishim propozuar taksën investive më të lartë se 0.40%.

Kryetari – sipas kërkesës së deputetëve, të rishikoni edhe njëherë kërkesën, të bëni korrigjimet në pjesën operacionale, të heqni shujtën. Gjithashtu të bëni një kalkulim për shpenzimet e dy muajve të parë të këtij viti, në bazë të taksës së kaluar siç e parasheh ligji.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Kërkohej nga Fondi që deri të hënën më 2.3.2015, të rishikojë kërkesën për miratimin e taksave menaxhuese për vitin 2015, dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme në buxhetin e propozuar dhe në nivelin e përqindjen e taksave menaxhuese, në bazë të vërejtjeve të anëtarëve të Komisionit (përfshirë heqjen e shujtës dhe informata për shpenzimet e buxhetit të Fondit për muajin janar-shkurt 2015). Komisioni do të rishqyrtojë kërkesën për miratimin e taksave menaxhuese për vitin 2015, dhe do të hartojë raportin me rekomandime për Kuvendin.

4. Caktimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit

Kryetari – propozojë që të formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për akcizën në produktet e duhanit, të paraparë me planin e punës së komisionit për këtë vit, me këtë përbërje: Bardhyl Meta (kryesues), Labinotë Demi-Murtezi, Visar Ymeri, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Pas propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

- I. Caktohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit, me këtë përbërje: Bardhyl Meta (kryesues), Labinotë Demi-Murtezi, Visar Ymeri, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.
- II. Grupi Punues, brenda afatit të paraparë me planin e punës së komisionit për vitin 2015, përgatit raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim për komisionin.

5. Caktimi i grupit punues për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Kryetari – propozojë që të formohet grupi punues për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të paraparë me planin e punës së komisionit për këtë vit, me këtë përbërje: Latif Gashi (kryesues), Besa Gaxherri dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Pas propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

- I. Caktohet grupi punues për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të

parapare me planin e punës së komisionit për këtë vit, me këtë përbërje: Latif Gashi (kryesues), Besa Gaxherri dhe Donika Kadaj-Bujupi.

- II. Grupi Punues monitoron nivelin të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës në viti 2013, dhe i rekomandon komisionit për mbikëqyrjen apo jo të Ligjit.

6. Të ndryshme

6.1. Kryetari – njoftoj se me zëvendëskryetaren e parë të komisionit, kanë biseduar me Guvernatorin e BQK-së në lidhje me hartimin e Projektligjit për institucionet mikrofinanciare, që nuk do të jetë punë e lehtë. Është një draft që nuk është përfunduar sepse na duhet shumë konsultime dhe ekspertiza. Por është një çështje që duhet me përfunduar, për arsye se Gjykata Kushtetuese, i ka shfuqizuar nenet që kanë të bëjnë me institucionet mikrofinanciare nga ligji për bankat.

Safete Hadergjona – çështja e mikrofinancave është një problem që e kemi para vetes dhe duhet me zgjedhë, pasi që me heqjen nga ligji për bankat, nuk ka baza ligjore dhe këto institucione vazhdojnë të operojnë me sistem të vjetër. Çdo raport i Bankës Qendrore, tregon se ka një sasi të madhe mjeteve në rritje nga këto institucione, që po përdoren për kreditim dhe për çështje të ndryshme. Ne si komision duhet me u përball me probleme dhe me qenë vullneti i mirë i të gjithë anëtarëve të komisionit, për me zgjidhë këtë çështje. Ndoshta kishte me qenë mirë që draftin që kemi, ta konsultojmë me Bankën Qendrore për të parë nevojën me i paraqit ndryshimet e nevojshme. Si dhe të formohet një grup punues që të fillojë me punë qysh tani, në mënyrë që të analizojmë mirë situatën dhe të përballemi me të gjitha çështjet, deri ne miratimin e këtij ligji.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani